



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

Nr. 1044/2 prot.

B.Curri, më 17.02. 2026

Lenda : Dergim Projekt Vendim “*Per Hapjen E Rruges Automobilistike Nga Rruge Kembesore Nga Lagjia Kalbaj Ne Lagjen Gabraj , Fshati Selimaj , Njesia Administrative Bujan, Bashkia Tropoje.*”

Drejtuar : Keshillit Bashkiak Tropoje

Te nderuar Keshilltare po iu dergojme Projekt Vendimin dhe relacionin shpjegues “*Per Hapjen E Rruges Automobilistike Nga Rruge Kembesore Nga Lagjia Kalbaj Ne Lagjen Gabraj , Fshati Selimaj , Njesia Administrative Bujan, Bashkia Tropoje*”

Bashngjitur kesaj shkrese do te gjeni :

- | | |
|--|---------|
| - Projekt Vendim | 2 faqe |
| - Relacion shpjegues | 2 faqe |
| - Preventiv | 2 faqe |
| - Kerkese te kryeplakut te fshatit Selimaj dhe Administratorit Bujan | 2 faqe |
| - Urdher per verifikim kerkese | 1 faqe |
| - Proces Verbal Konstatimi | 3 faqe |
| - Projekt Ide te rruges | 11 faqe |

Konceptoi : Dr.DPZHT-se E.Muhametaj

KRYETARI I BASHKISE TROPOJE

Rexhë BYBERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

Nr. 1044 prot.

B.Curri, më 17 . 02 . 2026

P/ VENDIM

Nr _____ Datë _____. _____. 2026

**PER HAPJEN E RRUGES AUTOMOBILISTIKE NGA RRUGE KEMBESORE NGA
LAGJIA KALBAJ NE LAGJEN GABRAJ , FSHATI SELIMAJ , NJESIA
ADMINISTRATIVE BUJAN, BASHKIA TROPOJE.**

Këshilli i Bashkisë Tropojë , në mbledhjen e tij të datës _____. _____. 2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbështetje të pika 2 të nenit 8, të nenit 9 pika 1/1 shkronja “b”, nenit 23 pika 4 dhe 14; të Ligjit Nr.139/215 datë 17.12.2015 Për “*Vetëqeverisjen Vendore*”, (i ndryshuar); Ligjit nr 9270 dt 29.07.2004 “*Per sistemin e adresave*” (i ndryshuar); shkronja “F” e pikës 2 të Ligjit 8378 datë 22.07.1998 “*Kodi Rrugore i Republikës së Shqipërisë*”, (i ndryshuar); Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*” (i ndryshuar); VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*” (i ndryshuar); Ligj nr.57/2020 “*Per Pyjet*”, VKM nr.649 date 21.05.2008 “*Per miratimin e listes perfundimtare te pronave, pyje dhe kullota, qe do te transferohen ne pronesi te njesise se qeverisjes vendore, Komuna Bujan , te Qarkut Kukes*”; VKM 378 date 08.04.2009 “*Per miratimin e listes se inventarit te pronave te paluajtshme shtetore ne komunen Bujan , te Qarkut Kukes*” ; kërkesës së paraqitur nga kryeplaku i fshatit Selimaj dhe Administratori i Njesise Bujan me nr.4266 Prot. date 18.09.2025; Proçes verbalit ne konstatimit ne nr.5188/1 Prot. date 11.11.2025 te verifikimit faktik ne terren te kerkeses.

VENDOSI

1. Miratimin e zgjerimit te rruges kembesore dhe pershatjen e saj ne rruge automobilistike nga Lagjia Kalbaj deri ne lagjen Gabraj, Njesia Administrative Bujan me nje gjatesi 1.245 km sipas projektit dhe relacioni teknik bashkngjitur. Kjo rruge shtrihet ne pasuri te paregjistruara dhe zbatohet pika 7 , nenit 16 te Aktit Normativ nr.8 date 01.10.2025 “*Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr.107/2014, “Për Planifikimin Dhe Zhvillimin E Territorit”*”(i ndryshuar).
2. Punimet dhe mirembajtja e rruges automobilistike do te kryhen nga komuniteti i zones dhe Drejtoria e Sherbimit te Bashkise Tropoje.

3. Pas ndertimit, rruga do te jete ne perdorim te te gjithe komunitetit dhe prone e Bashkise Tropoje , ne inventarin e rrugeve rurale te saj.

4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Tropoje (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit, Drejtoria e Sherbimeve, dhe Njesia Administrative Bujan).

5.Ky vendim hyn sipas nenit 55 pika 6 te ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”

Per DPZHT- ne:

Pergjegjesi i DPZHT-se Endrit Musaj

Drejtori i DPZHT-se Egzon Muhameta

Ligjshmeria:

KRYETARI I BASHKISE TROPOJË
Rexhë BYBERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 1044/11 Prot.

B.Curri, më 17.02. 2026

RELACION TEKNIKE

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të kërkesës së paraqitur nga banorët e Lagjes Gabraj, Fshati Selimaj, si dhe të shkresës së Administratorit të Njesisë Administrative Bujan me nr.144 Prot. date 17.09.2025 protokolluar prane Bashkise Tropoje me nr.4266 Prot. date 18.09.2025 , Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit paraqet për shqyrtim relacionin teknik për hapjen e rrugës automobilistike lidhëse nga Lagjia Kalbaj deri në Lagjen Gabraj.

Kjo kërkesë është shqyrtuar në terren nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tropojë Nr. 315, datë 30.10.2025. Gjatë verifikimit u kryen matje faktike, u analizua gjendja ekzistuese dhe u vlerësuan punimet e domosdoshme për funksionalizimin e këtij aksi rrugor.

Aksi i propozuar ka një gjatësi totale prej 1245 metra linearë. Rruga aktualisht ekziston si shteg këmbësor dhe nuk plotëson asnjë kriter për qarkullim automjetesh. Terreni është i thyer, me pjerrësi të theksuar, formacione shkëmbore, shkurre dhe zona pyjore, çka e bën të pamundur aksesin e mjeteve për shërbime bazë, ndërhyrje emergjente dhe transport të banorëve.

Rruga fillon në vazhdimësi të rrugës automobilistike ekzistuese në pikën me koordinata X 20°00'58.8240" dhe Y 42°18'14.1408" dhe përfundon në pikën me koordinata X 20°00'39.1380" dhe Y 42°18'24.8738". Segmenti i parë me gjatësi rreth 225 ml është rrugë ekzistuese, e cila kërkon pastrim, zgjerim rreth 1 m dhe hapje kanali anësor për drenazhimin e ujërave. Segmentet pasuese zhvillohen kryesisht mbi rrugë këmbësore ekzistuese dhe në terren natyror, duke kërkuar punime të plota germimi, formimi trupi rruge dhe stabilizimi.

Gjatë inspektimit u konstatuan pika kritike që kërkojnë ndërhyrje me vepra arti. Në progresivin rreth 0+100 m evidentohet një tombino ekzistuese që kërkon ndërtim portalesh betoni. Në progresivin rreth 0+430 m kërkohet ndërtimi i një kompleti tombinoje me tuba betoni Ø 800 mm dhe ndërtimi i një muri mbajtës me gjatësi rreth 30 m dhe lartësi rreth 3 m. Në progresivin 0+625 m kërkohet ndërtimi i një ure me hapje HD 3 m për kalimin mbi përroin ekzistues. Një tjetër komplet tombinoje Ø 800 mm kërkohet në progresivin rreth 0+775 m.

Segmentet me bazament shkëmbor kërkojnë germim shkëmbor me mjete mekanike dhe mjete shpërthyes të kontrolluara. Volumet mesatare të germimit variojnë nga 2.3 m3 për metër linear në segmentet ekzistuese, deri në 6.3 m3 për metër linear në segmentet e reja, me lartësi skarpate mesatare nga 1.8 m deri në 2.1 m.

Aksi rrugor kalon kryesisht në zona me shkurre dhe pyllësi të ulët. Sipërfaqja e vlerësuar e ndikimit në vegjetacion është rreth 3500 m2, ndërsa rreth 40 përqind e gjatësisë ndjek gjurmë ekzistuese ose toka bujqësore, duke kufizuar ndikimin mjedisor.

Bazuar në këto konstatime, është hartuar preventivi përkatës i punimeve, i cili përfshin punime germimi, shtresa rrugore, vepra arti, tombino dhe ndërtim ure. Vlera totale e punimeve, sipas preventivit të bashkëlidhur, është 17,394,377 lekë me TVSH **ku ne baze te kerkeses do te realizohet nga kontributi I vete banoreve.**

Hapja e kësaj rruge ka rëndësi të drejtpërdrejtë për komunitetin e Lagjes Gabraj, pasi siguron akses automobilistik, përmirëson kushtet e jetesës, mundëson ndërhyrje në banesat e amortizuara dhe garanton lidhjen funksionale të lagjes me pjesët e tjera të fshatit Selimaj dhe territorin e Bashkisë Tropojë.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit i propozon Këshillit Bashkiak Tropojë shqyrtimin dhe miratimin e këtij relacioni teknik dhe të ndërhyrjes së propozuar për hapjen e rrugës automobilistike Kalbaj Gabraj, në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të infrastrukturës lokale, sipas modelit të mëparshëm të përdorur për ndërhyrje infrastrukturore.

Me respekt,

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Spec. Time Kuçana

Pergj. Endrit Musaj

Dr. Egzon Muhametaj

KRYETARI I BASHKISË TROPOJË

Rexhë BYBERI



**PREVENTIV PUNIMESH****OBJEKTI : REHABILITIM RRUGA KALBAJ - GABRRAJ FSHATI SELIMAJ**

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
1. PUNIME GERMIMI NE RRUGE						
1	3.2	Prerje bime te vogla $\varnothing$ -10cm	m2	4000	36.84	147,360
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh $\varnothing$ 10 - 20 cm	cope	80	184.18	14,734
3	3.101/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke	m3	6220	190.28	1,183,542
4	3.25/a	Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b < 1 m, h=1.5 m, toke e zak.	m3	60	2,256.19	135,371
5	3.124/3a	Germim shkemb sek.i lire me mina te vogla, eskavator 1m3+transport	m3	430	1,637.08	1,637
6	3.87/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	300	311.69	93,507
7	3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	260	712.10	712.10
SHUMA 1:						1,414,057
2. PUNIME SHITESASH NE RRUGE						
1	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	5600	992.46	5,557,776
3	3.212/a	Shtrese stabilizanti t=5cm	m2	5600	306.40	1,715,840
7	An.1	Transport binderi dhe asfalti nga fabrika ne veper distance 10km	m2	3484	24.78	86,334
SHUMA 2:						7,359,950
3. PUNIMET E VEPRAVE TE ARTIT						
1	3.137	Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m ³ , ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke (Themele)	m3	480	689.36	330,893
2	3.235	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gure	m3	305	12,032	3,669,879
3	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (Beton per Puseta)	m3	15	15,717	235,759
4	3.243/1	Struktura monolite betoni C 16/120(Beton per koka muri)	m3	7	15,885	111,194
5	3.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	360	1,558.02	560,887
6	3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm	m2	9.5	416.30	3,955
7	3.365	Tombino me tuba betoni $\varnothing$ 600, mbi shtrese betoni	m	0	6,545.77	0.00
8	3.366	Tombino me tuba betoni $\varnothing$ 800, mbi shtrese betoni	m	6	12,194.3	73,165.56
Shuma 2						4,985,732
SHUMA A						13,759,739
URE B/ARME ME HD - 3M						
1	3.97/b	Germim me ekskavator me zinxhir 0.25 m3 kanale me gjeresi ~2m, ne prani uji, me shkarkim ne toke	m3	50	234.53	11,727
2	3.25/a	Germim me krah seksion I detyruar me gjersi b < 1m, h-1.5m toke e zakonshme	m3	10	2256.19	22,562
3	3.237	Struktur monolite b/betoni C-12/15 me 20% gure (themel e ballna Ure)	m3	35.3	11961.3	422,235
4	3.244	Struktur monolite betoni C- 20/25 (jasteku)	m3	1.5	16632.9	24,949
5	3.244	Struktur monolite betoni C- 20/25 (bordura + breza)	m3	1.7	16815.8	28,587

6	3.237	Struktur monolite b/betoni C-12/15 me 20% gure (Shpatull Ure)	m3	24	8628.28	207,079
7	3.245	Struktur e holle monolite Betoni C 25/30 (Solet e bordur)	m3	3.6	17732.53	63,837
8	3.287	F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6~10 mm	ton	0.40	163523.7	65,409
9	3.288	F.V. Hekur betoni I zakonshem Ø > 12 mm	ton	0.30	142716.73	42,815
10	3.353	Mbushje me shkemb te germuar me pare pas mureve	m3	26	1703.66	44,295
11	3.208	Shtres makadam 10cm perhap e ngjesh me makineri	m2	40	456.94	18,278
		SHUMA B				951,772
		SHUMA A - B				14,711,511
Fondi Rezervë (5.0%)						735,575.55
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (3.0%)						14,495,314
Shuma TVSH (20%)						2,899,063
Shuma me TVSH						17,394,377

Ky preventiv u realizua ne baze te Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

Grupi i punes

Ing. Egzon Muhametaj

Ark. Endrit Musaj

Tek. Mustaf Vatoci

MIRATO I
KRYETARI I BASHKISE TROPOJE

Rexhë BYBERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYETARI

Nr. 5188 prot.

B. Curri, më 30 . 10. 2025

URDHER

Nr. 315, datë 20. 10. 2025

PËR

“Ngritjen e grupit të punës për verifikimin faktik në terren , sipas kërkesës së banorëve të Fshatit Selimaj Geghysen , Lagjia Selimaj ; Kryeplakut të fshatit Selimaj”.

Bazuar ne ligjin Nr. 139/2015, datë.17.12. 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”; VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”; kërkesës nr.4266 Prot. Date 18.09.2025

URDHEROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës si më poshtë , për verifikimin faktik në terren sipas kërkesës së banorëve të Fshatit Selimaj Geghysen , Lagjia Selimaj nr.4266 date 18.09.2025 sipas shkreses bashkëngjitur
2. Perberia e Komisonit do jete si me poshte:

1. Egzon Muhametaj	(Kryetar)
2. Time Kuçana	(Anetar)
3. Endrit Musaj	(Anetar)
4. Kujtim Buçpapaj	(Anetar)
5. Ukë Ndreaj	(Anetar)
3. Grupi i punes do te perpiloj raport lidhur me konstatimet
4. Ngarkohet per zbatimin e ketij urdher grupi i punes
5. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I BASHKISE TROPOJE

Rexhë BYBERI



X/17 4266. Prot
17.18.08.2025



Shkronit Mubranshi
17.08.2025
H. H. H.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJË
NJËSIA ADMINISTRATIVE BUJAN

Nr. 144 Prot

Bujan më 17.08. 2025

Drejtuar: Bashkisë Tropojë

Lënda: Kërkesë për dhënie leje për hapjen e rrugës automobilistike Kalbaj – Gabraj

Banorët e fshatit **Selimaj – Geghysen**, lagjja **Gabraj**, paraqesin këtë kërkesë për dhënien e lejes për hapjen e rrugës automobilistike që lidh lagjen **Kalbaj** me lagjen **Gabraj**, me gjatësi rreth 750 metra linearë.

Rruga e propozuar kalon në një terren shkëmbor dhe me shkurre. Aktualisht, lagjja **Gabraj** nuk ka rrugë automobilistike funksionale, gjë që e bën të pamundur qasjen me mjete transporti. Për pasojë, mbi 80% e banesave ndodhen në gjendje të rrënuar, dhe ndërhyrjet për riparim apo rindërtim nuk mund të realizohen pa një rrugë të përshtatshme për mjete.

Hapja e kësaj rruge është planifikuar të realizohet kryesisht me kontributin e banorëve të lagjes **Gabraj**, ndërkohë që kërkohet nga Bashkia Tropojë miratimi i lejes dhe mbështetje institucionale sipas mundësive.

Kjo ndërhyrje ka rëndësi jetike për komunitetin, pasi do të përmirësojë kushtet e jetesës, do të mundësojë ndërhyrje në banesat e dëmtuara dhe do të sigurojë lidhjen e lagjes me pjesët e tjera të fshatit.

Në këtë kuadër, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Tropojë të shqyrtojë me prioritet këtë kërkesë dhe të miratojë dhënien e lejes për hapjen e rrugës automobilistike **Kalbaj – Gabraj**.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni listën e firmosur nga banorët e fshatit **Selimaj**, Lagjja **Gabraj**, Njësia Administrative Bujan, Tropojë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

ADMINISTRATORI

Kujtim Buçpapaj



KËRKESË

DREJTUAR: Bashkisë Tropojë


Të nderuar drejtues të Bashkisë Tropojë!

Ne banorët e fshatit Selimaj Geghysen lagja Gabraj kërkojmë nga ana juaj të na e mundësoni lejen për hapjen e rrugës automobilistike nga lagjia Kalbaj deri në lagjen Gabraj me gjatësi 750 ml. Rrugë e cila kalon në një terren shkëmbor dhe shkurre. Kjo kërkesë vjen pasi ne si lagje nuk kemi rrugë automobilistike si dhe 80% e shtëpive janë të rrënuara dhe për të bërë ndërhyrje për riparimin e këtyre shtëpive është e nevojshme një rrugë makine. Kjo rrugë do të bëhet me kontributin tonë si banor të kësaj lagjeje. Pra ne si banorë kërkojmë nga ana juaj që të na e mundësoni lejen për hapjen e kësaj rruge me kontributin tonë.

Duke shpresuar në një përgjigje positive nga ana juaj.


Me respekt

Banorët e Fshatit Selimaj Geghysen Lagjia Selimaj

1. Shkëlzen Haxhi Gabraj — G-9112801188 N — 
2. Fatbardh Hysen Gabraj — NR-70695296881 — 
3. Mehmet Hysen Gabraj — G-9042007019 — 
4. Fatmir Hysen Gabraj — 
5. Skender Haxhi Gabraj — 
6. Agron Haxhi Gabraj — H-6120507210 T — 
7. Gezim Haxhi Gabraj — 
8. Uke Halil Gabraj — 
9. Brahim Halil Gabraj — G-703110973 N — 
10. Jusuf Halil Gabraj — 
11. Sokol Halil Gabraj — 
12. Elvis Isa Gabraj — 
13. Arjan Tahir Gabraj — 
14. Besnik Tahir Gabraj — 
15. Mehmet Ram Gabraj — G-812160014 D — 
16. Gezim Ram Gabraj — 
17. Bekim Gabraj — I-80601086 F — 
18. Isa Gabraj — F-00510135 K — 
19. Luan Gabraj — H-00616024 N — 

Kryetari Fshatit Selimaj

Ukë Ndreaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 5188/1 Prot.

Bajram Curri, më 11.11.2025

PROCES VERBAL KONSTATIMI

Sot, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tropojë Nr. 315, datë 30.10.2025, grupi i punës i ngritur për këtë qëllim u paraqit në terren për të kryer verifikimin faktik dhe konstatimin teknik lidhur me kërkesën për hapjen e rrugës automobilistike nga Lagjia Kalbaj deri në Lagjen Gabraj, Fshati Selimaj, Njësia Administrative Bujan.

Gjatë inspektimit u konstatua se aksi i propozuar ka një gjatësi totale prej 1245 metra linearë. Rruga ekzistuese shërben aktualisht si rrugë këmbësore dhe shteg kalimi, pa parametra funksionale për qarkullim automjetesh. Terreni paraqitet i thyer, me pjerrësi të theksuar, formacione shkëmbore, shkurre dhe zona pyjore.

Objekti fillon në vazhdimësi të rrugës automobilistike ekzistuese në pikën me koordinata X 20°00'58.8240" dhe Y 42°18'14.1408", dhe përfundon në pikën me koordinata X 20°00'39.1380" dhe Y 42°18'24.8738".

Nga fillimi i aksit deri në progresivin 0+225 m, rruga është ekzistuese dhe përdoret për akses lokal drejt zonës së Kalasë së Lekës. Ky segment kërkon pastrim, zgjerim rreth 1 m dhe hapje kanali anësor. Gjatë verifikimit u vlerësua nevoja për germim mesatar rreth 2.3 m³ për metër linear, me lartësi mesatare skarpate rreth 1.8 m.

Në progresivin rreth 0+100 m u konstatua ekzistenca e një tombinoje të vjetër me elementë ushtrie, e cila kërkon ndërtim portalesh betoni në të dy anët për funksionim të sigurt hidraulik.

Nga progresivi 0+225 m deri në 0+625 m, aksi kalon në një rrugë këmbësore ekzistuese. Ky segment kërkon formatim të plotë të trupit të rrugës, zgjerim, germim dhe sistemim. Volumi i germimit u vlerësua afërsisht 5.8 m³ për metër linear. Në progresivin rreth 0+430 m u konstatua nevoja për ndërtimin e një kompleti tombinoje me tuba betoni Ø 800 mm, me pusët përkatëse, si dhe ndërtimin e një muri mbajtës në krahun e majtë me gjatësi rreth 30 m dhe lartësi rreth 3 m.

Në progresivin 0+400 m deri në 0+450 m, bazamenti i rrugës paraqitet formacion shkëmbor. Ky segment kërkon germim shkëmbor me volum mesatar rreth 5.8 m³ për metër linear dhe lartësi skarpate rreth 2.1 m.

Në progresivin 0+625 m u konstatua nevoja për ndërtimin e një ure me hapje HD 3 m, për të siguruar kalimin mbi përroin ekzistues dhe vazhdimësinë e aksit rrugor.

Nga progresivi 0+625 m deri në 0+1245 m, rruga ndjek kryesisht gjurmën e rrugës këmbësore ekzistuese. Ky segment kërkon germim mesatar rreth 6.3 m³ për metër linear, me lartësi skarpate

mesatare rreth 2.1 m. Në progresivin rreth 0+775 m u konstatua nevoja për realizimin e një kompleti tjetër tombinoje Ø 800 mm për menaxhimin e ujërave sipërfaqësore.

Gjatë inspektimit u evidentua se trupi i rrugës kalon kryesisht në zona me shkurre dhe pyllësi të ulët. Sipërfaqja e vlerësuar e ndikimit në vegjetacion është rreth 3500 m². Rreth 40 përqind e aksit ndjek rrugë ekzistuese ose toka bujqësore, duke kufizuar ndikimin në mjedis.

Bazuar në gjendjen faktike në terren, grupi i punës konstatoi se hapja e këtij aksi rrugor kërkon punime të plota germimi, formimi trupi rruge, shtresa mbajtëse, vepra arti, tombino dhe ndërtim ure, sipas preventivit të hartuar dhe të bashkëlidhur këtij proces verbal.



Ky proces verbal u mbajt për të pasqyruar gjendjen reale në terren dhe për të shërbyer si bazë teknike për vijimin e procedurave administrative dhe vendimmarrëse për hapjen e rrugës automobilistike Kalbaj Gabraj.

Proces verbali u hartua në tre kopje me të njëjtën përmbajtje dhe u firmos nga anëtarët e grupit të punës.

GRUPI I PUNES/ DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Ing.Egzon MUHAMETAJ



Ark.Time KUÇANA



Ark.Urb.Endrit MUSAJ





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TROPOJEI

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
REXHE BYBERI



OBJEKTI: RRUGE AUTO KALBAJ ~ GABRRAJ

PROJEKT IDE

PLANIMETRIA

TROPOJE DHJETORE 2025

HOROGRAFIA

PLANIMETRIA E RRUGES AUTO KALBAJ - GABRRAJ



Lamnica

FUNDI I PROJEKTIT

Gabrraj


Kalbaj

FILLIMI I PROJEKTIT

B.Curi

 ZYRA E URBANISTIKES Adresa: Sheshi "Azem Hajdari" B.Curi tel : +35521322373 E-mail: bashkiatropoje@gmail.com	OBJEKTI :RRUGA KALBAJ - GABRAJ NJESIA ADMINISTRATIVE BUJAN		
	AUTORE TE PROJEKTIT : Ing. EGZON MUHAMETAJ Ing. ENDRIT MUSAJ Ark. TIME KUÇANA Tek. MUSTAF VATOCI		
POROSITES : BASHKIA TROPOJE	EMERTIMI I FLETES : PLANIMETRIA		
	FLETA NR: 3	SHKALLA 1 : 500	DATE DHJETOR 2025

PLANIMETRIA E RRUGES AUTO KALBAJ - GABRAJ





ZYRA E URBANISTIKES
Adresa: Sheshi "Azem Hajdari" B.Curi
tel.: 05521322373
E-mail: bashkiatropoje@gmail.com

FOROSITES:
BASHKIA TROPOJE

OBJEKTI RRUGA KALBAJ - GABRAJ
NJESIA ADMINISTRATIVE BUJAN

AUTORE TE PROJEKTT:
Ing. EGZON MUHAMETAJ
Ing. ENDRIT MUSAJ
Ark. TIME KUÇANA
Tek. MUSTAF VATOCI

EMERTIMI I FLETES:
HAROGRAFIA

FLETA NR: 4	SHKALLA: 1 : 500	DATE: DHJETOR 2025
-----------------------	----------------------------	------------------------------

Lamnica

FUNDI I PROJEKTIT



ZYRA E URBANISTIKES
Adresa: Sheshi "Azem Hajdari" B.Curri
tel :+35521322373
E-mail: bashkitropeje@gmail.com


POROSITES :
BASHKIA TROPOJE

OBJEKTI :RRUGA KALBAJ - GABRAJ				
NJESIA ADMINISTRATIVE BUJAN				
AUTORE TE PROJEKTIT :		EMERTIMI I FLETES :		
Ing. EGZON MUHAMETAJ		PLANIMETRIA		
Ing. ENDRIT MUSAJ		FLETA NR:	SHKALLA	
Ark. TIME KUÇANA				DATE
Tek. MUSTAF VATOCI				
		5	1 : 500	



PLANIMETRIA Sek. 38 ~ Sek. 51

SH- 1:500

Gabrraj



PLANIMETRIA Sek. 29 ~ Sek. 38
SH- 1:500





ZYRA E URBANISTIKES
Adresa: Sheshi "Azem Hajdari" B.Curri
tel :+35521322373
E-mail: bashkiatropoje@gmail.com

OBJEKTI :RRUGA KALBAJ - GABRAJ
NJESIA ADMINISTRATIVE BUJAN


AUTORE TE PROJEKTIT :		EMERTIMI I FLETES :	
Ing. EGZON MUHAMETAJ		PLANIMETRIA	
Ing. ENDRIT MUSAJ			
Ark. TIME KUÇANA			
Tek. MUSTAF VATOCI			

POROSITES :
BASHKIA TROPOJE

FLETA NR:	SHKALLA	DATE
6	1 : 500	DHJETOR 2025

PLANIMETRIA Sek. 19 ~ Sek. 24

SH- 1:500



ZYRA E URBANISTIKES



Adresa: Sheshi "Azem Hajdari" B.Curri
tel :+35521322373
E-mail: bashkiatropoje@gmail.com

POROSITES :
BASHKIA TROPOJE

OBJEKTI :RRUGA KALBAJ - GABRAJ		
NJESIA ADMINISTRATIVE BUJAN		
AUTORE TE PROJEKTIT :		
Ing. EGZON MUHAMETAJ		
Ing. ENDRIT MUSAJ		
Ark. TIME KUÇANA		
Tek. MUSTAF VATOCI		
EMERTIMI I FLETES :		
PLANIMETRIA		
FLETA NR:	SHKALLA	DATE
8	1 : 500	DHJETOR 2025

PLANIMETRIA Sek. 13 ~ Sek. 19

SH- 1:500



ZYRA E URBANISTIKES

Adresa: Sheshi "Azem Hajdari" B.Curri
tel :+35521322373
E-mail: bashkiatropoje@gmail.com

POROSITES :

BASHKIA TROPOJE

OBJEKTI :RRUGA KALBAJ - GABRAJ
NJESIA ADMINISTRATIVE BUJAN

AUTORE TE PROJEKTIT :

Ing. EGZON MUHAMETAJ

Ing. ENDRIT MUSAJ

Ark. TIME KUÇANA

Tek. MUSTAF VATOCI

EMERTIMI I FLETES :

PLANIMETRIA

FLETA NR:

9

SHKALLA


1 : 500

DATE

DHJETOR 2025

PLANIMETRIA Sek. 07 ~ Sek. 13

SH- 1:500



ZYRA E URBANISTIKES

Adresa: Sheshi "Azem Hajdari" B.Curri
tel :+35521322373
E-mail: bashkiatropoje@gmail.com

POROSITES :
BASHKIA TROPOJE

OBJEKTI :RRUGA KALBAJ - GABBAJ			
NJESIA ADMINISTRATIVE BUJAN			
AUTORE TE PROJEKTIT :		EMERTIMI I FLETES :	
Ing. EGZON MUHAMETAJ		PLANIMETRIA	
Ing. ENDRIT MUSAJ		FLETA NR:	
Ark. TIME KUÇANA		SHKALLA	
Tek. MUSTAF VATOCI		DATE	
		DHJETOR 2025	

PLANIMETRIA Sek. 01 ~ Sek. 07

SH- 1:500



B.Curri

FILLIMI I PROJEKTIT
000 + 0

Kalbaj

M/MBAJTES L = 15m. H-3m

001 + 100

S-03-S

0 + 075

S-04

0 + 050

S-03-S

0 + 025

S-02-S

0 + 125

S-06

0 + 150

S-07



ZYRA E URBANISTIKES

Adresa: Sheshi "Azem Hajdari" B.Curri
tel :+35521322373
E-mail: bashkiatropoje@gmail.com

POROSITES :

BASHKIA TROPOJE

OBJEKTI :RRUGA KALBAJ - GABRAJ
NJESIA ADMINISTRATIVE BUJAN

AUTORE TE PROJEKTIT :

Ing. EGZON MUHAMETAJ

Ing. ENDRIT MUSAJ

Ark. TIME KUÇANA

Tek. MUSTAF VATOCI

EMERTIMI I FLETES :

PLANIMETRIA

FLETA NR:

11

SHKALLA

1 : 500

DATE

DHJETOR 2025